



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



PSH.nr. 22/19

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje z.Blerim Dina – Kryetar, z.Nuhi Paçarizi - Referues, z.Goran Milenković - Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik “Dreni-A” Sh.p.k. - Fushë Kosovë, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, ku është rekomanduar për kontratë OE “Marimanga” Sh.p.k – Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull prokurimit: “Shërbimet e transportit me marimangë-Ritender” Lot 1”, me numër të prokurimit: 616-18-8971-2-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Komuna Prishtinë (KK-PRISHTINË), më datën 06.02.2019 mori këtë:

V E N D I M

I. APROVOHET, si pjesërisht e bazuar ankesa e operatorit ekonomik “Dreni-A” sh.p.k. – Fushë Kosovë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Shërbimet e transportit me marimangë-Ritender” Lot 1”, me numër të prokurimit: 616-18-8971-2-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Komuna Prishtinë (KK-PRISHTINË).

II. ANULOHET, njoftimi për dhënie të kontratës, lidhur me aktivitetin të prokurimit me titull “Shërbimet e transportit me marimangë-Ritender” Lot 1”, me numër të prokurimit: 616-18-8971-2-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Komuna Prishtinë (KK-PRISHTINË), dhe lënda kthehet ne rivlerësim për Lot 1.

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 23.9 dhe 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues “Dreni-A” sh.p.k. – Fushë Kosovë, aprovohet pjesërisht si e bazuar, i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 33 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

ARSYETIM

Njoftimi për kontratë në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit është bërë me dt:16.11.2018

Hapja e ofertave është bërë me dt:04.12.2018

Njoftimit me letrën standarde për tenderues të pa suksesshëm 24.12.2018

Kërkesa për rishqyrtim me dt:31.12.2018.

Autoriteti Kontraktues me datën 04.01.2019 ka marrë vendim që të refuzohet kërkesa për rishqyrtim si e pa bazuar.

Operatori ekonomik ankues “Dreni-A” sh.p.k. – Fushë Kosovë, si palë e pa kënaqur, ka deponuar ankesë në OSHP, me 14.01.2019 me nr. 22/19, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Shërbimet e transportit me marimangë-Ritender” Lot 1”, me numër të prokurimit: 616-18-8971-2-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Komuna Prishtinë (KK-PRISHTINË), duke pretenduar se janë shkelur dispozitat.

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 1, 7, 28, 59, 65, 69, 108/A neni 9.1 & 9.2 të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 18.01.2019 ka autorizuar ekspertin shqyrtues profesional të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të

palës ankimore.

Eksperti Shqyrtues në raportin e dt:28.01.2019, konstaton dhe sqaron si në vijim:Lidhur me pretendimin e OE ankues, se autoriteti kontraktues e rekomanduar për kontratë për Lot 1 OE i cili nuk e ka veprimtarinë adekuate për natyrën e këtij aktiviteti të prokurimi sepse mungojnë kodet e veprimtarive 4942 dhe 5210, eksperti shqyrtues ka këtë mendim.

Në njoftimin për kontratë dhe në dosjen e tenderit nuk janë theksuar në kërkesë kodet e veprimtarive ekonomike 4942 dhe 5210 siç pretendon OE ankues. Operatori ekonomik i rekomanduar për kontratë në çertifikatën e regjistrimit të bizneseve ka kodet e veprimtarive për aktivitete shërbyese për transport tokësor, veprimtari këto që i përgjigjen natyrës së këtij aktivitetit të prokurimit. Prandaj eksperti shqyrtues e vlerëson këtë pretendim ankimor të pa bazuar.

Lidhur me pretendimin tjetër të OE ankues se AK ka bërë korrigjime në listën e çmimeve të ofertës së OE të rekomanduar për kontratë në Lot 1 dhe për këtë është dashur ti njoftoj të gjithë operatorët ekonomik, gjë të cilën AK nuk e ka bërë, Eksperti shqyrtues ka këtë mendim.

Lista e çmimeve është dhënë për të gjitha ofertat dhe ajo është publike edhe në platformën elektronike për prokurim publik, të cilën mund ta shohin të gjithë. Eksperti shqyrtues nuk ka vërejte ndonjë përmirësim apokorrigjim të çmimit në ndonjë pozicion të listës së çmimeve të OE të rekomanduar për kontratë e cila ndryshon nga çmimet të dhëna në platformën elektronike. Ashtu siç është çmimi i ofertës së OE të rekomanduar për kontratë në platformë i njëjti çmim është edhe në njoftimin e AK për operatorin ekonomik të rekomanduar për kontratë për Lot 1 që është më vlerë totale të peshuar 5,50. Pra nuk kemi të bëjmë me korrigjime të çmimeve në ofertë. Prandaj edhe ky pretendim ankimor është i pa bazuar.

Lidhur me pretendimin tjetër të OE ankues se lista e kontratave të OE fitues është po thajse identike me listën e kontratave të OE “Besa Cola” datat e lidhjes së kontratave janë po thajse të njëjtat, ndryshon vetëm blerësi, po ashtu si ka mundësi që kontrata është e lidhur në vitin 2012 dhe përfundon në vitin 2018, cila dispozitë e LPP-së e rregullon këtë çështje, eksperti shqyrtues ka këtë mendim.

Pse kontratat e dy operatorëve ekonomik janë po thajse identike, ky fakt nuk e bënë të pa përgjegjshëm njërin ose tjetrin OE. Kjo është e mundshme me ndodhë edhe është krejt ligjore. E rëndësishme është që OE i rekomanduar për kontratë të ofroj listën e kontratave dhe ta plotësoj kërkesën e dosjes së tenderit. Po ashtu një kontratë e lidhur në vitin 2012 dhe e përfunduar në vitin 2018 është në përputhje me ligjin e prokurimit publik. Ky ligj me asnjë dispozitë të tije nuk e kufizon jetëgjatësinë e kontratave publike, përveç kontratave publike Kornizë. Operatori ekonomik fitues për Lot 1 ka ofruar listën e kontratave në përputhje me kërkesën e dosjes së tenderit. Në kërkesën e dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë

është kërkuar lista e kontratave të bashkangjitur me referenca që dëshmojnë vlerat e kontratave të cilat duhet të arrijnë vlerën totale së paku 50.000,00 €. Në këtë formë edhe është ofruar nga OE i rekomanduar për kontratë i cili me shumën e kontratave ka tejkaluar vlerën e kërkuar prej 50.000,00 €.

Pse OE i rekomanduar për kontratë ka prezantuar në listën e kontratave edhe kontrata me kompani private, kjo nuk e bën të pa përgjegjshëm atë. Edhe kontratat me kompani private kanë të njëjtin efekt si ato me kompani publike ose institucione shtetërore. AK ka verifikuar pasqyrat financiar të pagesave për shërbimet e kompanisë fituese dhe ka konstatuar se plotësohet kërkesa. OE ankues nuk ka ofruar asnjë provë që e dëshmon të kundërtën për këto kontrata të OE fitues. Prandaj edhe ky pretendim ankimor është i pa bazuar.

Lidhur me pretendimin vijues të OE ankues se OE i rekomanduar për kontratë nuk i ka plotësuar kushtet teknike dhe profesionale sepse nuk ka ofruar 2 automjetet për bartje, njërin me vinç me 4 mengelet dhe tjetrin me litarë tërheqës dhe së paku 20 bllokues sipas kërkesës në pikën 9.1 dhe 9.2 të dosjes së tenderit, eksperti shqyrtues ka këtë mendim.

OE i rekomanduar për kontratë për Lot 1 në ofertën e tij ka bashkangjitur dëshmitë për 2 automjetet kamion për bartje të veturave. Janë dhënë fotot e automjeteve që dëshmojnë se në njëri është me vinç dhe tjetri me litar. Po ashtu në foto dëshmohen edhe 4 mengelet dhe 20 bllokues të kërkuar nga AK. Si dëshmi për kamionët janë dhënë edhe librezat e qarkullimit, regjistrimit të automjeteve.

Në kërkesën e DT nuk ka qenë që librezat e qarkullimit të dëshmojnë që automjeti është me vinç ose me litar. Por janë kërkuar që të prezantohen fotot. Nga fotot shihet se automjetet janë sipas kërkesës. Pra me këto dëshmi OE e ka plotësuar kërkesën e dosjes së tenderit për aspektin tekniko/profesional që lidhet me automjetet për bartje. Prandaj edhe ky pretendim ankimor është i pa bazuar.

Sa i përket pretendimit të fundit të OE ankues se autoriteti kontraktues ja ka shkëputur një anshëm një kontratë OE të rekomanduar për kontratë për shkak të mos përmbushjes së detyrimeve dhe është dashur të përjashtoj tani nga aktiviteti i prokurimit, eksperti shqyrtues ka këtë mendim.

Për të dhënë përgjigjeje në këtë pretendim ankimor duhet të posedojmë dokumente lidhur me kontratën që supozohet se është shkëputur nga AK dhe OE fitues. Cilat kanë qenë arsyet e shkëputjes së kontratës dhe në çfarë mënyre është shkëputur. Edhe nëse është bërë shkëputje e njëanshme e kontratës siç pretendon OE ankues, jo detyrimisht AK duhet ta përjashtoj nga aktiviteti i prokurimit tani operatorin ekonomik. Kjo varet prej ZKA të autoritetit kontraktues si e vlerëson situatën.

Nëse para hapjes së ofertave nuk ka pasur ndonjë vendim të autoritetit kontraktues për përjashtim të ofertës së OE fitues që do ta pamundësonte edhe leximin e çmimit të ofertës, tani në këtë fazë pas hapjes së ofertave është i detyruar AK që ta bëjë vlerësimin e ofertës së OE fitues. Meqenëse po flasim për një aktivitet tjetër të prokurimit dhe asnjë dëshmi nuk është ofruar nga OE ankues se si është shkëputur

kontrata paraprahe, atëherë e vlerësoj si pretendim ankimor të pa bazuar.

Gjatë procesit të ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve autoriteti kontraktues në përgjithësi ka respektuar dispozitat e ligjit të prokurimit publik. Eksperti shqyrtues gjatë analizimit dhe shqyrtimit të pretendimeve ankimor nuk ka vërejt ndonjë shkelje të dispozitave të LPP-së të cilat e dëmtojnë procesin e prokurimit.

Është rekomanduar për kontratë për Lot 1, OE i cili ka ofruar çmimin më të ulët me vlerë totale të peshuar prej 5,50 krahasuar me ofertën e OE ankues që ka çmimin më të lartë në vlerë totale të peshuar 5,80. Pra është respektuar kriteri i dhënies së kontratës.

Në bazë të sqarimeve të lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të refuzohet për arsyen që i theksuam në përgjigjeje të pretendimeve ankimore të më sipërme.

Eksperti shqyrtues në përputhje me nenin 114 pika 2 të LPP-së rekomandon autoritetin kontraktues që vazhdoj me lidhjen e kontratës për aktivitetin e prokurimit “Shërbimet e transportit me marimangë-Ritender” Lot 1 me nr.prokurimi 616-18-8971-211” në bazë të dispozitave të LPP-së.

Operatori ekonomik përmes parashtresës me shkrim të datës: 31.01.2019, ka njoftuar Panelin shqyrtues se nuk pajtohet me raportin e ekspertit shqyrtues.

Autoriteti Kontraktues përmes parashtresës me shkrim të datës: 28.01.2019, ka njoftuar Panelin shqyrtues se pajtohet me raportin e ekspertit shqyrtues.

Në seancën e shqyrtimit kryesor të datës 06.02.2019, ku kanë qenë prezent paneli shqyrtues, përfaqësuesi i autoritetit kontraktues dhe operatorit ekonomik ankues, u shqyrtuan shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit shqyrtues, parashtresat e palëve në procedurë.

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesi i OE-së z. Gashi deklaroi: Si përfaqësuesi i OE mbesim në tërësi pran ankesës të parashtrua me dt 14.01.2019 si dhe të gjitha pretendimeve në këtë ankesë njëkohësisht e kundërshtojmë raportin e ekspertit shqyrtues për faktin se konsiderojmë se ky raport është i njëanshëm dhe jo i bazuar drejt konform gjendjes faktike dhe pretendimeve ankimore të parashtruara në ankesë lidhur me pretendimet ankimore, propozoj që përfaqësuesi, pronari i OE-së të sqaroj pikat mbi bazën e të cilave e kemi mbështetur edhe ankesën z. Morina vazhdoj: lidhur me pretendimin e parë nuk pajtohem me mendimin e ekspertit e ka hedh poshtë pasi OE e ka veprimtarinë e biznesit për shërbimet e transportit

tokësor te mallrave por ky grup i OE nuk e ka aktivitetin e magazinimin dhe ruajtjes qe ne ketë rast sipas kërkesave te FDT-se parashihet bllokimi i automjeteve ne vend dhe se kompania qe do te shpërblehet me kontrate është e obliguar qe te bej ruajtjen e tyre deri ne momentin qe ky automjet lirohen e qe këto shërbime janë te rregulluar me kodin 52/10 qe do te ishte ne veprimtarin e biznesit e këtë Grupi OE nuk e kane. Sa i përket pretendimit 3 OE “Marimanga” sh.p.k dhe NTSH “Marimanga” tek kontratat dhe referencat, ne kërkesën tone për qasje ne dokumentacion nuk na është dhen sipas zyrtareve komunal OE ka kërkuar qe këto dokumente ka plotësuar deklaratën për sekret dhe shumica e këtyre referencave kontratave janë lëshuar nga kompani private dhe neve nuk kanë dëshmuar transaksionet bankare qe përshihet ne LPP. Po ashtu këtu shohim qe ka kontrata te cilat janë lidhur ne vitin 2012 dhe përfundojnë ne vitin 2018 dhe mendojmë qe janë te pavlefshme pasi qe nuk mund te lidhet kontrata ne një afat kohor te tille Prove lista e kontratave te OE “Marimanga” me siguri e keni ne dosje. Poashtu OE “Marimanga” nuk i ka plotësuar kërkesat teknike nga se nuk ka dëshmuar automjetet ashtu siç janë kërkuar konkretisht ne Dosje te tenderit, është kërkuar qe OE te këtë se paku 2 automjete transportuese njeri te jetë me vinç dhe tjetri te jetë me litar tërheqës, ndërsa OE “Merimanga” nuk ka ofruar Kamion me vinç kjo dëshmohet me librezën e automjetit ne te cilën evidentohet si kamion i zakonshëm si prove mund ti referoheni librezave te automjeteve tona ne dosje ku automjetet janë te destinuar Automjet me vinç për transportim te veturave. Dhe kërkojmë qe te aprovohet kërkesa jone si e bazuar dhe lënda te kthehet ne rivlerësim.

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesi i AK-së znj. Dalipi deklarojnë: AK mbështet mendimin e ekspertit ne tërësi dhe pasi OE ankues janë te pabazuara kërkojmë qe ankesa e OE te refuzohet dhe kërkojmë nga paneli shqyrtues te përkrahët vendimi i AK-se. Sa i përket kodeve profesionale te dy OE qe janë ne Konsorcium i kanë ndërsa magazinimi behet ne prone te komunës.

Gjatë prezantimit në seance Eksperti shqyrtues z. Kurtishaj deklarojë: Bazuar ne pretendimet e ngritura nga OE ankues kam dhen përgjigjet duke u bazuar ne kërkesat e dosjes dhe te dhënave qe ka dhen OE i rekomanduar për kontrate shkurtimisht ne pikat te cilat u ceken nga te pranishmeve sa i perke shërbimeve dhe kodeve te ekonomike te veprimtarisë te OE te rekomanduar për kontrate unë mendoj se OE ne fjalë e ka plotësuar këtë kërkesë te FDT-se sepse ai e përmban veprimtarin ekonomike shërbime te transportit siç theksohet ne FDT dhe askund nuk janë kërkuar kodet ekonomike qe i përmendi OE ankues kodet , edhe ne kërkesën për rishqyrtim AK shume qartë e ka sqaruar se Automjetet ruhen ne vende te caktuara nga Komuna dhe nuk është përgjegjës OE për ruajtjen e tyre. Pika tjetër për kontratat qe ka OE i rekomanduar për kontrate kjo çështje ekziston si e tillë janë prezantuar si kontrata por nuk e benë te papërgjegjshëm OE për faktin se ligji nuk ndalon se OE te paraqesin edhe kontrata me kompani private. Pika ne lidhje me

kërkesa teknik e kam cekur ne raport edhe ne dok e OE për kontrate janë dhen automjetet ashtu siç janë kërkuar ne FDT njeri me litar dhe njeri me vinç (Nr i librezës janë ashtu si ne foto). OE i rekomanduar është me ilire ka oferte ekonomike ne bazë te dosjes unë i kam dhen AK te drejt se procesi i vlerësimit ka qen ne përputhje me ligjet e LPP-se qëndroj ne tërësi mbrapa raportit tim te dorëzuar.

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit shqyrtues, deklaramit të palëve në procedurë, diskutimeve dhe shoshitjes së provave në tërësi gjatë seancës për shqyrtim kryesor, sqaron se Operatori Ekonomik ankues pretendon se AK ka rekomanduar për kontrate OE i cili është i pa përgjegjshëm pra qe nuk i plotëson kërkesat e AK-se ne njoftimin për kontrate dhe dosje te tenderit.

Lidhur me pretendimin se OE i rekomanduar per kontrate nuk i ka kodet e veprimtarive sipas keresave te dosjes, Paneli shqyrtues e konstaton këtë pretendim ankimor të pa bazuar pasi që, në njoftimin për kontratë dhe në dosjen e tenderit nuk janë theksuar në kërkesë kodet e veprimtarive ekonomike 4942 dhe 5210 siç pretendon OE ankues. Operatori ekonomik i rekomanduar për kontratë në çertifikatën e regjistrimit të bizneseve ka kodet e veprimtarive për aktivitete shërbyese për transport tokësor, veprimtari këto që i përgjigjen natyrës së këtij aktivitetit të prokurimit.

Lidhur me pretendimin tjetër të OE ankues se AK ka bërë korrigjime në listën e çmimeve të ofertës së OE të rekomanduar për kontratë në Lot 1 dhe për këtë është dashur ti njoftoj të gjithë operatorët ekonomik, gjë të cilën AK nuk e ka bërë, Paneli shqyrtues edhe konform sqarimeve te ekspertit shqyrtues profesional te prokurimit konstaton se ky pretendim ankimor është i pa bazuar. Lista e çmimeve është dhënë për të gjitha ofertat dhe ajo është publike edhe në platformën elektronike për prokurim publik, të cilën mund ta shohin të gjithë. Sipas sqarimeve te ekspertit shqyrtues profesional nuk ka vërejte ndonjë përmirësim apo korrigjim të çmimit në ndonjë pozicion të listës së çmimeve të OE të rekomanduar për kontratë e cila ndryshon nga çmimet të dhëna në platformën elektronike. Ashtu siç është çmimi i ofertës së OE të rekomanduar për kontratë në platformë i njëjti çmim është edhe në njoftimin e AK për operatorin ekonomik të rekomanduar për kontratë për Lot 1 që është më vlerë totale të peshuar 5,50. Pra nuk kemi të bëjmë me korrigjime të çmimeve në ofertë.

Lidhur me pretendimin tjetër të OE ankues se lista e kontratave të OE fitues është po thuajse identike me listën e kontratave të OE “Besa Cola” datat e lidhjes së kontratave janë po thuajse të njëjtat, ndryshon vetëm blerësi, po ashtu si ka mundësi që kontrata është e lidhur në vitin 2012 dhe përfundon në vitin 2018, cila dispozitë e LPP-së e rregullon këtë çështje, Paneli shqyrtues obligon autoritetin kontraktues qe

te kërkoj sqarime nga OE i rekomanduar për kontrate lidhur me kontratat konform nenit 59 dhe 72 të LPP-së.

Lidhur me pretendimin vijues të OE ankues se OE i rekomanduar për kontratë nuk i ka plotësuar kushtet teknike dhe profesionale sepse nuk ka ofruar 2 automjetet për bartje, njërin me vinç me 4 mengelet dhe tjetrin me litarë tërheqës dhe së paku 20 bllokues sipas kërkesës në pikën 9.1 dhe 9.2 të dosjes së tenderit, Paneli shqyrtues obligon autoritetin kontraktues që të kërkoj sqarime nga OE i rekomanduar për kontrate lidhur me këtë kërkesë konform nenit 59 dhe 72 të LPP-së se a e plotëson OE i rekomanduar për kontrate. Në kërkesën e DT janë kërkuar edhe librezat e qarkullimit të automjeteve, nga vet fakti që janë kërkuar librezat AK ka dashur që ta vërtetoj edhe destinimin e atyre automjeteve nëpërmjet librezave, pra AK ka kërkuar që të plotësohen dy dëshmi që janë librezat dhe fotot. Nga fotot shihet se automjetet janë sipas kërkesës. Por OE i rekomanduar për kontrate duhet të dëshmoj se atë automjet e ka përshtatur për këtë veprimtari me ane të dëshmive bindëse apo duke e vërtetuar AK nga një komision i caktuar për këtë.

Sa i përket pretendimit të fundit të OE ankues se autoriteti kontraktues ja ka shkëputur një anshëm një kontratë OE të rekomanduar për kontratë për shkak të mos përmbushjes së detyrimeve dhe është dashur të përjashtoj tani nga aktiviteti i prokurimit, Paneli shqyrtues edhe konform sqarimeve të ekspertit shqyrtues profesional të prokurimit sqaron se nuk posedojmë dokumente lidhur me kontratën që supozohet se është shkëputur nga AK dhe OE fitues. Cilat kanë qenë arsyet e shkëputjes së kontratës dhe në çfarë mënyre është shkëputur. Edhe nëse është bërë shkëputje e njëanshme e kontratës siç pretendon OE ankues, jo detyrimisht AK duhet ta përjashtoj nga aktiviteti i prokurimit tani operatorin ekonomik. Kjo varet prej ZKA të autoritetit kontraktues si e vlerëson situatën.

Nëse para hapjes së ofertave nuk ka pasur ndonjë vendim të autoritetit kontraktues për përjashtim të ofertës së OE fitues që do ta pamundësonte edhe leximin e çmimit të ofertës, tani në këtë fazë pas hapjes së ofertave është i detyruar AK që ta bëjë vlerësimin e ofertës së OE fitues. Meqenëse po flasim për një aktivitet tjetër të prokurimit dhe asnjë dëshmi nuk është ofruar nga OE ankues se si është shkëputur kontrata paraprake, atëherë e vlerësoj si pretendim ankimor të pa bazuar.

Paneli shqyrtues konstaton se ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i ofertave nuk është bërë konform nenit 59, 60 dhe 72 të LPP-së. Paneli shqyrtues duke u bazuar në ecurinë e këtij aktiviteti të prokurimit obligon AK-në, që gjatë rivlerësimit të ofertave të bënë vlerësim real të ofertave sipas kërkesave të vendosura nga vet AK në njoftimin për kontrate dhe në dosje të tenderit dhe konform nenit 59 dhe 72 të LPP-se të kërkoj sqarime shtese nga OE i rekomanduar për kontrate.

Paneli shqyrtues sqaron se autoriteti kontraktues duhet te ketë në konsideratë nenin 1 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

Po ashtu autoritetet kontraktuese duhet vepruar në harmoni me nenin 6 të LPP-së, ku autoritetet kontraktuese janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit ashtu siç parashihet në nenin 6 të LPP-së. Gjithashtu autoriteti kontraktues duhet vepruar në pajtim me nenin 59 dhe 60 dhe 72 te LPP-së.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet vetëm Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative për kompensim dëmi ne afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues
Blerim Dina



Vendimi t'i dorëzohet:

- 1x1 AK –Komuna Prishtine (KK-PRISHTINË),
- 1x1 OE- “Dreni-A” sh.p.k. – Fushë Kosovë
- 1x1 Arkivës së OSHP-së;
- 1x1 Për publikim në web- faqe të OSHP-së.